



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura IV**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 97

Prishtinë, më 3.2.2014, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S1

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

**Në mbledhje morën pjesë:** Arben Gashi, Behar Selimi, Mufera Shinik, Arsim Bajrami, Haki Demolli, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Gëzim Kelmendi dhe Sreten Ivanoviq.

**Munguan:** Ardian Gjini dhe Halit Krasniqi.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Artan Canhasi dhe Granit Vokshi - EULEX, Arta Berisha – Top Chanel, Blerta Aliu – Koha Ditore, Vjollcë Xhota - IPKZH, Marie Nikolla – Rrokum TV, Valmira Saraçi – KTV, Amire Qamili – Kosova Press, Myrna Macgregor – Ambasada e Brfitanisë së Madhe, Albert Krasniqi – KIPRED, Sefadin Kllokoqi – D4D, Lumnije Murati – ZPRK, Petrit Hysaj – OSBE, Vlora Nushi – OPA-UNMIK, Bryan Marus dhe Bajram Gecaj– Ambasada e SHBA-së dhe Valbona Merija- GCPS.

**Nga stafi i Komisionit për Legjislacion:** Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi,** Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.12.2013;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës;
4. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit të punës në Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë, të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë;

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-197 për kimikate;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L- 230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;
7. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i rendit të ditës;**

*Kryetari konstatoi se rendi ditës u miratua pa ndryshime.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.2.2014;**

*Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 16.2. 2014, pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës;**

**Kryetari-** Tha se me vendimin e Kuvendit nr. 04-V-764, i datës 31 janar 2014, është ngarkuar Komisioni për Legjislacion, që ta hartojë Projektligjin për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Ai tha se është marrë për bazë puna e komisionit ad-hoc për reformën zgjedhore dhe shumë çështje që janë propozuar nga ky komision, dhe tani ju është shpërnda një draft i spastruar i Projektligjit. Ai propozoi që të bëhet një plan pune se si do të punohet në këtë Projektligj, në mënyrë që deri në javën e ardhshme të gjithë anëtarët e Komisionit të kenë mundësi që ta analizojnë Projektligjin, në mënyrë që në mbledhjen e radhës ti paraqesin ato. Po ashtu, propozoi që me 11 dhe 12 shkurt, të mbahet një punëtori, ku do ta shqyrtohet Projektligji nen për nen.

**Arsim Bajrami** shprehu përkrahjen e Partisë Demokratike në këtë proces, veçanërisht puna e këtij Komisioni tha se duhet të fokusohet në ato çështje që kanë mbetur pa u harmonizuar nga Komisioni ad-hc për reformë zgjedhore. Po ashtu, ai tha se është në interes që të kemi një konsensus sa më gjithëpërfshirës, në mënyrë që të minimizojmë dallimet para se të shkojë në Kuvend. Në këtë proces është e rëndësishme që puna e Komisionit të përkrahet nga partitë politike dhe të na lihet një kohë e arsyeshme për ta përfunduar punën, duke përfshirë edhe konsultimet e brendshme.

**Haki Demolli** tha se Kuvendi ka vendosur që materiali i Komisionit ad-hoc për reformë zgjedhore ti përcillet Komisionit për Legjislacion, për çka jam pajtuar edhe unë. Mirëpo, ai shprehu shqetësimin e tij se në Kuvend disa deputetë ishin deklaruar se Komisioni ad-hoc për reformë zgjedhore nuk ka bërë asgjë, po ashtu shprehu shqetësimin edhe me rrjedhën e seancës së Kuvendit të 31 janarit. Kurse tani po e shihni se para vetes keni një Projektligj që ka dal si punë e atij komisioni dhe se problemi ishte mungesa e konsensusit të liderëve lidhur me çështjet që kanë të

bëjnë sistemin zgjedhor. Ai në pika të shkurta foli edhe për punën e Komisionit ad-hoc për reformë zgjedhore dhe mënyrën se si është punuar në këtë Komision, duke falënderuar përfaqësuesit e OSBE-së, KQZ-së, PZAP-it, Shoqërisë Civile, Komisionit Evropian, ICO-së, përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane dhe asaj Britanike.

**Albulena Haxhiu** tha se një nga ata deputet që e kanë kritikuar punën e Komisionit ad-hoc, jam edhe unë. Ajo u pajtua me parafolësin lidhur me rrjedhën e seancës së Kuvendit të 31 janarit, duke mos ju dhënë fjala disa deputetëve, kur është debatuar për këtë temë. Është mirë që debati është kthyer në nivel institucional, që të kemi një qasje gjithëpërfshirëse dhe jo dy apo tre liderë të marrin vendime për çështje shumë të rëndësishme. Po ashtu, është e vërtetë që Komisioni ad hoc ka bërë shumë ndryshime, mirëpo, prapë se prapë nuk janë marrë parasysh çështjet shumë të rëndësishme sepse shumica e ndryshimeve kanë qenë teknike. Çështjet që kanë të bëjnë me prapësin e zgjedhor, listën e votuesve, numërimi i rezultateve, dokumentet e vlefshme për votim, votimi i bashkatdhetarëve, fushata zgjedhore, vota preferenciale janë vetëm disa nga çështjet që nuk janë zgjidhur nga Komisioni ad hoc. Haxhiu u pajtua me planin e punës, të propozuar nga kryetari komisionit, lidhur me dinamikën e punës dhe kërkoi që Komisioni të punojë në përbërje të plotë, e jo të formohet grupi i punës.

**Armen Zemaj** u pajtua me planin e punës, të propozuar nga kryetari komisionit dhe e vlerësoi si pozitiv faktin që kjo reformë ka hy në procedurë të rregullt legjislative. Kjo nënkupton që edhe nëse paraqitet ndonjë neglizhencë e ndonjë grupimi politik, nuk e ndal punën e Komisionit. Është e rëndësishme që ky komision të ndjek logjikën e ndërtimit të një sistemi zgjedhor, i cili garanton zgjedhje demokratike. Nuk është e hijshme të thuhet që Komisioni ad hoc nuk ka bërë asgjë sepse ai komision ka funksionuar dhe ka punuar gati dy vite. Mund të ketë kritika lidhur me atë pse ajo punë nuk është finalizuar me një Projektligj, por nuk mund të thuhet që nuk ka bërë asgjë. Shpresoj që ajo që tha z. Bajrami në emër të Partisë Demokratike të mbetet ashtu, sepse pikërisht kjo parti ka qenë fajtorë pse reforma zgjedhore nuk ka ecur më tutje. Prandaj, në afatin sa më të shkurt duhet të fillojmë që të punojmë, për të arritur që në kohë të përfundojmë punën. Ai kërkoi nga anëtarët që mos të thirren në emër të liderëve politikë, për t'iu ikur përgjegjësi të veta, por të fokusohemi në proces.

*Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se në mbledhjen e radhës, e cila do të mbahet më 10.2.2014, të sillen propozimet eventuale nga deputetët, që do të diskutohen në punëtorinë që planifikohet të mbahet më 11-12 shkurt 2014.*

**4. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit të punës në Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë;**

**Armend Zemaj** arsyetoi amendamentet e propozuara nga grupi i punës duke thënë se ka pas disa dilema, të cilat i kemi diskutuar edhe me përfaqësuesit e Agjencisë kundër korrupsionit, mirëpo, ky është vetëm ndryshim, plotësim i ligjit dhe kërkoi që të përkrahen amendamentet e propozuara nga grupi i punës kurse amendamentet e deputetit Goran Marinković, tha se janë të karakterit gjuhësor që është obligim i Zyrës për Standardizim që t'i rregullojë.

Meqë nuk kishe diskutime tjera, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

## **P e r f u n d i m**

*I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit për Legjislacion.*

*II. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, me amendamentet e propozuara.*

*III. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.*

### **5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-197 për kimikate;**

**Kryetari**, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-197, për kimikate dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente ti paraqesin ato.

Meqë nuk kishte vërejtje, Kryetari Konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

## **Rekomandim**

1. Projektligjin nr. 04/L-197 për kimikate dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

### **6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L- 230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;**

**Kryetari** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L- 230, për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente ti paraqesin ato.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

### **Rekomandim**

1. Projektligjin nr. 04/L- 230, për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

### **7. Të ndryshme.**

**Njoftim me ekspertizën e z. Salih Mekaj, për PL për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja, me vendim të gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht.**

**Kryetari** i njoftoi me përmbajtjen e ekspertizës për Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht, të ekspertit, z. Salih Mekaj, i cili ju është shpërndarë së bashku me materialin për këtë mbledhje dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje para se të procedohet tutje.

*Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se konfirmohet përfundimi ekspertizës, sipas kushteve të përcaktuara në termat e referencës.*

Mbledhja përfundoi në orën 12:45

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit  
Arben Gashi

---

**Aneks – Amendamentet në Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë**

### **Amendamenti 1**

Neni 1, paragrafi 8, riformulohet si vijon: **“Anëtar i familjes – bashkëshortët, bashkëshortët jashtëmartesorë, prindërit dhe fëmijët me të cilët jeton në bashkësi familjare”**.

Paragrafi 9, në rreshtin e fundit hiqen **“kllapat dhe pika”** dhe shtohen fjalët **“ në afat prej 30 ditësh”**.

### **Amendamenti 2**

**Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit funksional.**

Në titullin e Projektligjit, fjala: “dopunama”, zëvendësohet me fjalën: “i dopunama”

Neni 1.1, fjala: “sluzbenika”, zëvendësohet me fjalën: “službenika”

Neni 1.2, fjala: “sefovi”, zëvendësohet me fjalën: “šefovi”

Neni 1.3, fjala: “ sefova zëvendësohet me fjalën: “ šefova

Neni 1.4, fjala: “ sefovi”, zëvendësohet me fjalën: “ šefovi”, si dhe fjala: “sto” zëvendësohet me fjalën: “što”

Neni 1.7, fjala: “(alineja, pod tacka), zëvendësohet me: “(alineje, pod tačke)”

Neni 1.8, fjala: “sto”, zëvendësohet me fjalën: “ što”, fjala: “partnera”, me fjalën: “bračni drug”, fjala: “ roditelja”, me fjalën: “roditelji”, fjala: “ usvojioca” me fjalën: “usvojioci”, fjala: “deca” me fjalën: “dete” dhe fjala: “krvnog” me fjalën: “ „krvni”

Neni 1.9, fjala: “vrsioci”, të zëvendësohet me fjalën: “vršioći” dhe fjala: “bogatstvo” me fjalën: “imovinu”

### **Amendamenti 3**

**Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit funksional.**

Neni 2 .1, fjala: “kontaktni sluzbenik”, të zëvendësohet me fjalën:” sluzbenik za kontakte“

Neni 3.2, fjala: “sto”, të zëvendësohet me fjalën:”što“

Neni 3.1.5, slovo: “u” zëvendësohet me:”, ndërkaq fjala: “kredite” të zëvendësohet me:”kredit“

Neni 3.1.7. fjala:„licni“ me fjalën: „lični“; fjala:„doho“ me fjalën“dohodak.”

#### **Amendamenti 4**

##### **Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit funksional.**

Neni 6.1.3, fjala:„Prigodne me fjalën:“Prigodnim“, fjala:„, poklone me fjalën:“poklonima“, fjala:„male“ me fjalën:“mali“, fjala:„,poklone me fjalën:“pokloni“, fjala:„Sluzbenik me fjalën:“ Sluzbenik“ , fjala:„,prigodan me fjalën:“ prigodne“, fjala:„,poklon me fjalën:“poklone“, fjala:„članka“ me fjalën:“člana“.

Neni 6.4, fjala: “kontakt sluzbenika“, me fjalën:“ sluzbenika za kontakt“

#### **Amendamenti 5**

##### **Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit funksional.**

Neni 7.2 fjala: “sluzbenik“ me fjalën:“ sluzbenik“, fjala:“kontakt sluzbenici“ me fjalën:“sluzbenici za kontakt“

Neni 7.3, fjala:“izbrisu“ të zëvendësohet me fjalën:” brišu“

Neni 7.5, fjala: “dizajnira format“ të zëvendësohet me:” izradi šablon“ , fjala:“ i prosleđuje“ të zëvendësohet me:” prosledi“, fjala:“kod javnih“ me fjalën:“ javnim“, fjala:“ institucija“, me fjalën:“ institucijama. "

Neni 7.9, fjala: “vođenja“, të zëvendësohet me:”čuvanja“, fjala:“za“, me fjalën:“u period od“

Neni 8, fjala: “sto” të zëvendësohet me fjalën:”što“

#### **Amendamenti 6**

##### **Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit funksional.**

Neni 9.5, fjala: “i deklarativni“, me fjalën:“deklarisani, može da se“, fjala:“ identifikira“, me fjalën:“ identifikuje“, fjala:“pokrije“, me fjalën:“pokriva“, fjalia:“će zatražiti od sluzbenika da pruži objašnjenja i dokaze“ të zëvendësohet me fjalinë:” zahteva od sluzbenika da daje relevantno objašnjenje i argumenata, fjala:“predstavljaju“ të zëvendësohet me fjalën:”podnose“.

Neni 9.6, fjala: “i se podlezu” të zëvendësohet me fjalën:“ podležu“, fjala:“podlezu“, me fjalën:“podležu“, fjala:“zdrebanja“, me fjalën:“ žrebanja“. Fjala:“zdrebanja“, me fjalën:“žrebanja“, fjala „vrsi“, me fjalën:“ vrši“

Neni 9.8, fjala: “i usvaja jednu” të zëvendësohet me:” će usvojiti“, fjala:“vrsenje“ të zëvendësohet me fjalën:”vršenje“

Neni 10.5, fjala:“ izaberu“, të zëvendësohet me fjalën:” biraju“

### **Amendamenti 7**

Neni 10, paragrafi **5, hiqet në tërësi.**

### **Amendamenti 8**

Neni 11, paragrafi 1, në rreshtin e parë, hiqet fjala **“ushtron”** dhe zëvendësohet me fjalën **“paraqet”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 3, në rreshtin e tretë, hiqen fjalët **“ apo dhuratave”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

### **Amendamenti 9**

**Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit funksional.**

Neni 11, fjala: “sto”, të zëvendësohet me fjalën:”što“.

Neni 17.1, fjala: “i u „, të zëvendësohet me fjalën:”kod“, fjala:“nadležnoj , me fjalën:“nadležnog, tuzilastvo me fjalën:“tužilaštva“, fjalën:“sluzbenika“ me fjalën:“službenika“, fjalën:“predvidjene“, me fjalën:“ predviđene, fjalën:“krivicnu“, me fjalën:“ krivičnu“.

### **Amendamenti 10**

**Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit funksional.**

Neni 17.2, fjala: “i sluzbenik me fjalën:“ službenik, radi ili je radio.

Neni 17.3, fjala: “i sluzbenika“ me fjalën:“službenika“, fjalën:“bogatstva“, me fjalën:“imovine“

Neni 12, fjala: “se ponovno brojanje“ të zëvendësohet me:“ se renumerisanje članova“

Neni 13, fjala: “sto” të zëvendësohet me fjalën:”što“

Propozohet heqja e të gjitha fjalëve fshira me viza: “dhe shtimi në vend të tyre i të gjitha fjalëve sië janë dhënë në tekstin e mësipërm, të cilat janë nënvizuar dhe shenjuar me ngjyrë tjetër.

